

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi”
Programi i lëndës “Gjuhë shqipe” (DRAFT)

SHKALLA E PARË DHE E DYTË



Qershor 2014

I. HYRJE

Lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Kjo fushë synon zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit që të përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

Mësimi i gjuhës shqipe dhe i gjuhëve të huaja, gjithashtu, zhvillon te nxënësit të menduarit kritik dhe i bën të vetëdijshëm për identitetin e tyre personal dhe kombëtar. Nëpërmjet leximit të teksteve nga letërsia shqipe dhe ajo botërore (në gjuhën shqipe ose në gjuhën e huaj), nxënësit zhvillojnë botën e tyre emocionale, pasurojnë përfytyrimet dhe imagjinatën e tyre për botën, çmojnë gjuhët dhe kulturën kombëtare e botërore.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën dhe kuriozitetin e nxënësve për t’u bërë lexues aktivë e të pavarur dhe shkrues të saktë, origjinalë dhe krijues. Po kështu, ajo zhvillon te nxënësit njohuritë, shkathhtësitë, qëndrimet dhe vlerat e duhura që ata të flasin dhe të dëgjojnë në mënyrë korrekte në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë.

Arritjet gjuhësore të nxënësve janë përcaktuese jo vetëm për lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”, por edhe për çdo lëndë që zhvillohet në shkollë. Nëse nxënësit nuk janë të aftë të dëgjojnë, flasin, lexojnë dhe shkruajnë mirë, atëherë ata nuk mund të jenë të suksesshëm në shkollë dhe në jetë. Duke pasur një rëndësi të tillë, fusha dhe lëndët që e përbëjnë atë, janë një nga detyrat parësore të arsimit bazë.

Korniza Kurrikulare përcakton si qëllim kryesor zotërimin e kompetencave kyçe, si të domosdoshme për një individ i cili duhet të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Çdo fushë të nxëni dhe lëndë duhet të synojë që ta pajisë

nxënësin me këto kompetenca. Këtë “mision” fusha e realizon nëpërmjet kompetencave të saj. Duke u bazuar në synimet dhe specifikat e fushës, pesë kompetencat e fushës “Gjuhët dhe komunikimi” janë:

1. Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme
2. Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar
3. Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare
4. Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale
5. Përdorimi i drejtë i gjuhës

Çdo lëndë e fushës synon t’i pajisë nxënësit me pesë kompetencat e mësipërme.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” përbëhet nga lëndët: **Gjuhë shqipe, Gjuhë e huaj e parë, Gjuhë e huaj e dytë**. Njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e nxënësve në një gjuhë i ndihmojnë ata të mësojnë dhe kuptojnë një gjuhë tjetër. P.sh., nxënësit zbatojnë njohuritë e tyre gjuhësore të gjuhës amtare gjatë mësimit të një gjuhe të huaj. Nga ana tjetër duke mësuar një gjuhë të dytë apo të tretë, nxënësit fillojnë ta çmojnë dhe vlerësojnë më shumë gjuhën apo kulturën e tyre. Ata vihen në situata që u mundësojnë atyre të kuptojnë se çfarë gjuhët kanë të përbashkët dhe çfarë i bën ato unike. Mësimi i këtyre lëndëve përgjatë nëntë viteve të arsimit bazë është si më poshtë:

Gjuha shqipe mësohet në të gjitha shkallët e kurrikulës, nga klasa përgatitore deri në klasën XII.

Gjuha e huaj e parë fillon në shkallën e dytë (klasa III) dhe mësohet deri në shkallën e gjashtë (klasa XII).

Gjuha e huaj e dytë fillon të mësohet në shkallën e tretë (klasa VI) dhe vazhdon deri në shkallën e gjashtë (klasa XII). Si gjuhë e huaj e dytë mund të jetë: gjuha frënge, gjuha italiane, gjuha gjermane etj.

Të gjitha lëndët e fushës së bashku synojnë të pajisin nxënësit me kompetencat kyçe dhe me kompetencat e fushës.

II. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE

Hartimi i programit të gjuhës shqipe mbështetet në dokumentet kryesore kurrikulare: Korniza Kurrikulare, Kurrikula Bërthamë dhe Plani Mësimor i Arsimit Bazë. Ky program shoqërohet me udhëzuesit kurrikularë dhe dokumente të tjera në ndihmë të mësuesve dhe hartuesve të teksteve mësimore.

Përdoruesit e programit janë mësuesit, autorët e teksteve, prindërit dhe komuniteti, specialistët e arsimit dhe fakultetet e mësuesisë.

Mësuesit do ta përdorin programin e gjuhës shqipe për të krijuar një tablo të qartë rreth asaj se çfarë duhet të mësojnë nxënësit dhe se si duhet të ndërtojnë mësimdhënien për të përmbushur kërkesat e programit.

Autorët e teksteve do ta përdorin programin e gjuhës shqipe për të hartuar tekste që janë në funksion të realizimit të tyre. Leximi i kujdesshëm i programit për çdo shkallë dhe klasë (nga klasa e parë deri në klasën e nëntë) do t'i ndihmojë për të siguruar koherencën dhe për të shmangur ngarkesën e panevojshme.

Prindërit dhe komuniteti nëpërmjet programit mund të informohen për njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të zotërojnë fëmijët e tyre në lëndën e gjuhës shqipe.

Specialistët e arsimit do ta përdorin programin e gjuhës shqipe për qëllime inspektimi, monitorimi vlerësimi, studimi etj.


Fakultetet e mësuesisë mund ta përdorin programin lëndor për të përshtatur kurrikulat e tyre, me qëllim përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm, si dhe për praktikën pedagogjike të studentëve.

Programi i gjuhës shqipe ka në fokus realizimin e kompetencave kyçe dhe kompetencave të fushës. Gjatë punës për përmbushjen e kompetencave kyçe dhe kompetencave të fushës, nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe do të realizohen temat ndërkurrikulare të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë dhe tregun e punës.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës shqipe me fushat e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, por tërësor.

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të fushës. Njohuritë janë përcaktuar për çdo klasë, ndërsa aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet janë përcaktuar për shkallë.

Diagrama e mëposhtme paraqet organizimin e programit.



1. Qëllimet e arsimit parauniversitar

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësit:

- kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;
- përdorin teknologjitë e reja.

2. Qëllimet e programit të gjuhës shqipe

Qëllimet e lëndës së gjuhës shqipe në arsimin bazë janë:

- Zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues.
- Kërkimi, gjetja, gjykimi në mënyrë kritike dhe përdorimi i informacionit që merret nga mediat dhe interneti.
- Njohja dhe vlerësimi i letërsisë shqipe dhe i letërsisë botërore nëpërmjet studimit të krijimtarisë së shkrimtarëve përfaqësues të periudhave të ndryshme (tekste të përshtatshme për moshën e nxënësve).

- Krijimi i besimit se përmes letërsisë dhe teksteve joletrare zhvillohet mënyra e të menduarit, bota shpirtërore dhe personaliteti i njeriut.
- Zotërimi i njohurive, aftësive, shkathtësive dhe qëndrimeve të duhura rreth sistemit gjuhësor të shqipes.
- Vlerësimi i gjuhës shqipe si vlerë e kulturës sonë kombëtare dhe si mjet komunikimi.

3. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës

Realizimi i kompetencave kyçe të Kornizës Kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyçe me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënit. ***Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.*** Kur nxënësi realizon kompetencat gjuhësore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh., gjatë prezantimeve të ndryshme në orët mësimore të kompetencës së të folurit për të komunikuar e për të mësuar, nxënësit përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe realizon kështu edhe kompetencën digjitale. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës ku bën pjesë lënda e gjuhës shqipe pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e përshtatshmërisë në jetë, shoqëri dhe punë.

Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetenca kyçe për secilin vit mësimor rezultatin/et e të nxënit për shkallë, për kompetencat kyçe;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e të nxënit, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit;

- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për fushën “Gjuhët dhe komunikimi”.

Diagrama e mëposhtme konkretizon lidhjen e kompetecave kyçe me kompetencat e fushës.




Tabela: Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe gjatë shkallës e parë dhe të dytë

Në Kurrikulën Bërthamë janë përcaktuar rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë kyçe. Këto rezultate realizohen nëpërmjet fushave të të nxënit. Natyrisht, secila fushë dhe lëndë mund të kontribuojë në disa rezultate të nxëni. Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe gjatë shkallës së parë dhe të dytë.

Shkalla 1	Shkalla 2
Nxënësi:	
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit	
<ul style="list-style-type: none"> ● ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar, përmbajtja e të cilit nuk është më shumë se një faqe teksti; ● shpreh me gojë dhe me shkrim për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi ose dokumentari, dëgjimit të një tregimi apo përralle; ● paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup; ● lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë; ● shkruan një tekst të shkurtër (gjysmë faqe për një temë të caktuar); ● shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë letrar, përmes njëres nga 	<ul style="list-style-type: none"> ● shpreh përjetimet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit dhe dëgjimit të një filmi, dokumentari, ekspozite, dramatizimi, recitimi, interpretimi muzikor ose leximit të një libri në njërin nga format shprehëse (me gojë, me shkrim, vizatim, mimikë, lëvizje etj.); ● dëgjon me vëmendje prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim me pyetje, komente apo sqarime; ● merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit; ● lexon saktë me zë një tekst letrar ose jo letrar të palexuar më parë; ● shkruan një tekst rreth një faqe për një temë të caktuar; ● identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi,

<p>format shprehëse: të folurit, shkrimit, dramatizimit (lojë me role);</p> <ul style="list-style-type: none"> ● sidentifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame apo filmi dhe luan rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët; 	<p>kënge dhe i analizon duke bërë një listë tiparet e tyre, diskuton rreth tyre, luan rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët;</p> <ul style="list-style-type: none"> ● shpreh me gojë dhe me shkrim fjali të thjeshta në gjuhën e huaj dhe i përkthen në gjuhën amtare; ● prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në një kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un;
<p>Kompetenca e të menduarit</p>	
<ul style="list-style-type: none"> ● sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore; 	<ul style="list-style-type: none"> ● identifikon për një temë/ngjarje, çështjet kryesore të marra nga burime të ndryshme informacioni (tekst mësimor, gazetë, internet, apo burime të tjera); ● paraqet argumente pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
<p>Kompetenca e të nxënit</p>	
<ul style="list-style-type: none"> ● ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim / aktivitet / detyrë, që kërkohet; ● parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/ detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit; 	<ul style="list-style-type: none"> ● shfrytëzon burime të ndryshme informacioni për përgatitjen e një teme të dhënë; ● identifikon dhe krahason informacionet e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh. duke i shënuar me shenja

- zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;
- mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen;
- grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal;

të ndryshme);

- krahason përparimin e tij, me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një veprimtarie të caktuar;
- përdor portofolin personal si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara, duke hartuar një plan pune me hapa konkrete për përmirësim;
- identifikon cilësitë, që zotëron dhe ato që duhen zhvilluar për të nxënë gjatë zhvillimit të një detyre apo veprimtarie të caktuar duke bashkëpunuar me të tjerët;
- prezanton për 6-10 minuta përvojën e vet;

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

- përgatit një plan të thjeshtë ditor me shkrim, për dy- tri aktivitete ditore, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e detyrës;
- gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup;
- identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi;

- përgatit një autobiografi ku prezanton veten, të dhënat personale dhe prirjet, që ka për fusha të caktuara, duke gjetur të përbashkëtat ,që ato kanë me profesionet e dëshiruara;
- përgatit një plan pune një javor;
- diskuton për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë, në shkollë dhe mjedise të tjera në një situatë të caktuar, duke prezantuar idetë nëpërmjet shembujve konkretë;

Kompetenca personale

- bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj;
- bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) drejt arritjes së një qëllimi të përbashkët. (projekti/aktiviteti në bazë klase /shkolle apo jashtë saj);

Kompetenca qytetare

- diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup;
- shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar;
- shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët;

Kompetenca digjitale

- ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet audio-vizuale), përmbajtja e të cilit të mos jetë më shumë se një faqe teksti;
- realizojnë punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.
- organizon dhe komunikon informacionin, duke përdorur mjetet e duhura të komunikimit teknologjik për të mbledhur informacion dhe për të komunikuar me të tjerët.

4. Lidhja e gjuhës shqipe me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Ato integrojnë fushat e të nxënës, të cilat ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë me jetën dhe me interesat e tyre. Në Kornizën Kurrikulare dhe në Kurrikulat Bërthamë janë përcaktuar temat ndërkurrikulare të cilat janë:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
- Të drejtat e njeriut
- Vendimmarrja morale
- Mjedisi
- Bashkëjetesa paqësore

Gjuha shqipe për specifikat dhe hapësirat që ka (këtu përfshihet edhe sasia e orëve mësimore) lejon krijimin e situatave mësimore të cilat mundësojnë trajtimin e këtyre temave. Kështu p.sh., leximi dhe studimi i teksteve të ndryshme letrare nga letërsia shqipe dhe botërore zhvillon te nxënësit identitetin dhe krenarinë kombëtare, si dhe njohjen e vlerësimit e kulturës botërore. Tema si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj. mund të realizohen gjatë diskutimeve dhe bashkëbisedimeve në grup të cilat zhvillohen gjatë orëve mësimore të kompetencës së të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar. Mësuesi mund të krijojë edhe situata mësimore gjatë të cilave nxënësit shprehen në forma të ndryshme: ese, poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë rreth çështjeve të mësipërme. Punët në grupe që zhvillohen në lëndën e gjuhës e shqipe ndihmojnë në krijimin e aftësive të nxënësve për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët.

5. Lidhja e gjuhës shqipe me fushat e tjera të të nxënës

Mësimi i gjuhës shqipe në shkollë (edhe lëndët e tjera të fushës “Gjuhët dhe komunikimi”) mbështet edhe realizimin e kompetencave të fushave të tjera të kurrikulës. Në gjuhën shqipe nxënësit: fitojnë njohuri, aftësi, shkathhtësi, vlera dhe qëndrime për

të komunikuar me gojë dhe me shkrim; lexojnë dhe kuptojnë tekste të llojeve të ndryshme; pasurojnë fjalorin dhe botëkuptimin e tyre duke lexuar tekste letrare; mësojnë të shkruajnë tekste të ndryshme (opinione, raporte, udhëzime etj.); mësojnë ta përdorin drejt dhe sipas rregullave gramatikore gjuhën etj. Të gjitha këto njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime sigurojnë suksesin e nxënësve edhe në fushat dhe lëndët të tjera. Natyrisht në këtë lidhje ka marrje dhe dhënie.

Kështu, p.sh., aftësitë e të lexuarit mbështetin kuptimin e ushtrimeve dhe teksteve matematikore, nga ana tjetër aftësitë për të zgjidhur probleme në matematikë ndikojnë në gjykimin dhe mendimin kritik të nxënësve.


Kuptimi ose analiza e teksteve të shkencave të natyrës kërkon aftësi të mira leximi. Po kështu, p.sh., leximi i një proze i ndihmon nxënësit të marrin njohuri rreth natyrës, siç njohuritë e marra në shkencat e natyrës nxitin imagjinatën për të realizuar me shkrim një përshkrim të natyrës.

Lënda e gjuhës shqipe (edhe gjuhët e huaja) mbështet nxënësit në mësimin e shkencave shoqërore. Leximi dhe analiza e teksteve letrare ndikon që të kuptohen më mirë ngjarjet e figurat historike, marrëdhëniet mes njerëzve dhe vlerat shoqërore.

Mësimi i arteve të ndryshme mbështetet nga letërsia (tekstet letrare që studiohen nga nxënësit) e cila është pjesë e tyre. Kështu, analiza e teksteve letrare i ndihmon nxënësit të kuptojnë mjetet e shprehjes artistike; studimi dhe krijimi i teksteve të ndryshme si p.sh., i reklamave kërkojnë integrim me artet për elementet pamore të reklamave; ilustrimi i një analize të një teksti letrar me muzikën e një periudhe të caktuar i ndihmon nxënësit të kuptojnë efektin emocional të muzikës dhe mjetet e shprehjes së saj artistike. Element i përbashkët mes muzikës dhe gjuhës shqipe janë edhe këngët popullore dhe krijimet e tjera folklorike, studimi i të cilave integron natyrshëm gjuhën dhe artet.

Shembujt e mësipërm janë vetëm një nxitje për të kuptuar se në procesin mësimor krijohen mundësi për integrim mes fushave të të nxënësit. Mësuesit me pasionin dhe përkushtimin që i karakterizon, mund të realizojnë pafund integrame mes fushave të të nxënësit. Ky integrim i lejon nxënësit të mos marrin njohuri të fragmentuara dhe të shkëputura nga jeta.

Në diagramën e mëposhtme janë dhënë aftësitë që gjuha shqipe u siguron fushave të tjera të të nxënësit.



6. Kompetencat e fushës

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” dhe të gjitha lëndët që bëjnë pjesë në këtë fushë realizojnë pesë kompetenca të cilat janë: të dëgjuarit e teksteve të ndryshme; të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar; të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare; të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale; përdorimi i drejtë i gjuhës.

Përshkrimi i kompetencave kyçe

a) Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Nxënësit marrin njohuri, zhvillojnë qëndrime dhe vlera, si dhe zbatojnë aftësi dhe shkathhtësi duke dëgjuar tekste të ndryshme.

Më konkretisht, nxënësit kuptojnë se sjellja dhe qëndrimet e duhura gjatë të dëgjuarit ndikojnë pozitivisht te të tjerët. Ata dallojnë disa cilësi të zërit të folësit si: intonacioni, ritmi, theksi, volumi i zërit. Gjithashtu, nxënësit tregojnë brendinë, veçojnë idenë kryesore, dallojnë fjalët ose frazat kyçe, bëjnë konkluzione, krahasojnë ose klasifikojnë, si dhe bëjnë vlerësime të thjeshta për tekstet që dëgjojnë.

b) Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Nxënësit: përdorin drejt gjuhën standarde gjatë folurit; kuptojnë dhe zbatojnë në komunikim karakteristikat e gjuhës së folur; shqiptojnë saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë, me qëllim që të jenë të kuptueshëm dhe interesantë për të tjerët; shoqërojnë të folurin edhe me elemente të komunikimit joverbal; diskutojnë dhe bashkëveprojnë me të tjerët gjatë punës në grup.

c) Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Nxënësit lexojnë tekste letrare dhe joletrare që u përkasin periudhave të ndryshme, tekste klasike dhe bashkëkohore, shqipe dhe botërore dhe demonstrojnë kuptimin, interpretimin, analizën, vlerësimin dhe gjykimin e këtyre teksteve (të përshtatshme për zhvillimin moshor të nxënësve).

d) Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Nxënësit shkruajnë për qëllime dhe lexues të ndryshëm. Ata ndjekin gjatë të shkruarit hapa si: planifikimi, organizimi i ideve, rishikimi dhe redaktimi. Nxënësit, gjithashtu, respektojnë strukturën, tiparet e tekstit, si dhe rregullat gjuhësore.

e) Përdorimi i drejtë i gjuhës

Që nxënësit të flasin dhe të shkruajnë në mënyrën e duhur, atëherë ata duhet të zotërojnë njohuri e të demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime në lidhje me sistemin gjuhësor të gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të huaja. Kështu, nxënësit dallojnë pjesët e ndryshme të ligjëratës, kategoritë e tyre gramatikore dhe i përdorin në trajtën e duhur gjatë komunikimit; dallojnë llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali dhe i zbatojnë këto njohuri në komunikimin e përditshëm; përdorin gjuhën standarde, njohin dialektet e pjesë të tjera të leksikut dhe respektojnë diversitetin gjuhësor; kanë njohuri për mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, dallojnë kuptimet e fjalëve dhe i përdorin për të pasuruar fjalorin e tyre.

7. Koha mësimore për secilën klasë

Gjuha shqipe është lëndë e detyrueshme në arsimin bazë. Ajo zhvillohet përgjatë nëntë viteve të këtij arsimi dhe zë afërsisht 1/4 të kurrikulës. Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore sipas kompetencave në dy shkallët e para. Kjo shpërndarje orësh

është sugjeruese dhe shuma e tyre është e barabartë me sasinë e orëve vjetore të përcaktuara në Planin Mësimor të Arsimit Bazë. Në klasën përgatitore, kohëzgjatja e orës së mësimit llogaritet me 25-30 minuta.

Nxënësit në lëndën e gjuhës shqipe, pothuajse çdo orë flasin, dëgjojnë, lexojnë, shkruajnë dhe fitojnë njohuri dhe shkathtësi rreth sistemit gjuhësor, megjithatë theksi vihet në njërin nga këto kompetenca. Ky fakt përcakton edhe orët për këtë kompetencë. P.sh., në klasën e dytë janë sugjeruar rreth 60 orë për kompetencën e të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale. Kjo do të thotë që nxënësit do të shkruajnë, pothuajse, në çdo orë mësimi, por theksi në këto 60 orë do të vihet më shumë te kjo kompetencë.

Koha mësimore për çdo kompetencë përdoret: **60- 70%** për njohuri të reja dhe **30 -40 %** përpunim njohurish, projekte, vlerësim, kurrikul në bazë shkolle. Mësuesi ka të drejtë të ndryshojë deri në masën 10% të orëve të një kompetence.

Kompetencat/ klasat	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Totali, orë
Klasa përgatitore	53	70	26	26	0	175 orë
Klasa e parë	10	10	160	70	30	280 orë
Klasa e dytë	10	10	150	60	50	280 orë
SHKALLA E PARË	73	90	326	156	90	735 orë

Klasa e tretë	10	10	95	35	60	210 orë
Klasa e katërt	5	5	75	30	60	175 orë
Klasa e pestë	5	5	75	30	60	175 orë
SHKALLA E DYTË	20	20	245	95	180	560 orë

III. QËLLIMET E SHKALLËS SË PARË DHE TË DYTË

ⁱGjatë shkallës së parë dhe të dytë nxënësit:

- komunikojnë në varësi të qëllimit dhe të situatës;
- përmbledhin tekstin që lexojnë ose dëgjojnë dhe e vlerësojnë atë (me gojë ose me shkrim);
- dallojnë llojet kryesore të teksteve dhe tiparet e tyre;
- kuptojnë, interpretojnë dhe analizojnë përmbajtjen e një teksti, marrëdhëniet mes personazheve, ndjenjat dhe vlerat e tyre;
- kuptojnë dhe pranojnë opinionet e ndryshme të të tjerëve rreth teksteve letrare dhe joletrare;
- krijojnë tekste të thjeshta për qëllime personale ose funksionale;
- përdorin burime të ndryshme për të gjetur informacion (fjalorë, enciklopedi ose burime online);
- njohin dhe zbatojnë fazat e të shkruarit dhe përgatitjes së një prezantimi;
- dallojnë dhe përdorin njohuritë themelore të gramatikës së gjuhës shqipe;
- njohin dhe zbatojnë rregullat e përgjithshme të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

1. Përmbajtja e shkallës së parë dhe të dytë

Në programin e gjuhës shqipe për shkallën e parë dhe të dytë janë paraqitur rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë. Kompetencat zhvillohen përmes disa *tematikave*. Tematikat dhe renditja e tyre nuk presupozojnë që realizimi i tyre përgjatë vitit shkollor ose shkallës, duhet të zhvillohet e ndarë në këtë renditje. Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në orë mësimi, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve). Më poshtë janë dhënë tematikat për çdo kompetencë.

a) Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

- Rregullat e të dëgjuarit;
- Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të vlerësuar tekstin

b) Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

- Rregullat dhe organizimi i të folurit
- Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup

c) Të lexuarit e teksteve të ndryshme

- Të lexuarit fillestar (klasa 1-3)
- Të lexuarit për të kuptuar
- Të lexuarit e teksteve letrare
- Të lexuarit e teksteve joletrare

d) Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

- Shkrimi i dorës

- Planifikimi, organizimi, rishikimi dhe redaktimi i të shkruarit
- Të shkruarit për qëllime personale
- Të shkruarit për qëllime funksionale

e) Përdorimi i drejtë i gjuhës

- Sintaksë
- Morfologji
- Leksikologji dhe semantikë
- Drejtshkrim
- Fonetikë dhe fonologji



SHKALLA 1
(klasa përgatitore, 1
dhe 2)

KOMPETENCA: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Përshkrimi i tematikave të kompetencës Nxënësi demonstroi sjellje dhe qëndrime të përshtatshme gjatë të dëgjuarit si: vëmendje, pëlqim dhe interes. Ai dëgjon dhe kupton një larmi tekstesh të folura, demonstroi se i ka kuptuar këto tekste, si dhe shpreh opinionet e tij rreth teksteve që dëgjon.	
Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">- demonstroi të kuptuarit e teksteve që dëgjon në situata të ndryshme;- ritregon me fjalët e tij përmbajtjen ose informacionin kryesor të një bisede, poezie, përralle, tregimi, rregulle praktike ose udhëzimi.	
Njohuritë	Shkathësitë
Njohuritë për klasën përgatitore Gjatë orëve të sugjeruara në program, fëmija dëgjon dhe reagon ndaj teksteve që janë të përshtatshme për moshën e tij, si: përralla, tregime, ndodhi personale, shfaqje për fëmijë, teatër me kukulla etj. Ai, gjithashtu, merr njohuritë e mëposhtme për rregullat e thjeshta gjatë të dëgjuarit si: vëmendje, kontakt me sy.	Rregullat e të dëgjuarit Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">- shfaq sjellje të përshtatshme gjatë të dëgjuarit si p.sh.:<ul style="list-style-type: none">• ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon;• nuk e ndërpret tjetrin, kur është duke folur;• e sheh në sy personin gjatë kohës që flet;

<p>Njohuritë për klasën e parë</p> <p>Gjatë orëve mësimore të sugjeruara në program, nxënësi dëgjon dhe punon (u përgjigjet pyetjeve, tregon përmbajtjen, ndan në pjesë tekstin, jep mendimet e tij rreth tekstit, shpreh pëlqimet e tij) me tekste të cilat janë të përshtatshme për moshën e tij si: përralla, fabula, biseda, ndodhi personale, emisione televizive, shfaqje për fëmijë, teatër me kukulla etj. Ai, gjithashtu, merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tregimi i përmbajtjes së tekstit. - Rregullat e thjeshta gjatë të dëgjuarit si: vëmendje, kontakt me sy, mosndërprerje gjatë të folurit. 	<ul style="list-style-type: none"> - shpreh pëlqim dhe interes ndaj tekstit që dëgjon: (<i>Më pëlqen kjo që po dëgjoj!</i>). <p>Të dëgjuarit për të kuptuar dhe vlerësuar tekstin</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tregon njohuritë paraprake që ka rreth temës ose përmbajtjes së tekstit që dëgjon; - u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit; - tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit (rreth një faqe teksti) duke e ilustruar me detaje dhe ilustrime; - ndan tekstin në pjesë; - shpreh përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi ose dokumentari, dëgjimit të një tregimi, fabule apo përralle; - lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera; - bën gjykime të thjeshta rreth tekstit; - shpreh pëlqimet e tij rreth ngjarjeve ose personazheve të tekstit; - veçon disa detaje interesante (muzika që shoqëron rrëfimin e një përralle, zëri i personazheve etj.) gjatë të
<p>Njohuritë për klasën e dytë</p> <p>Gjatë orëve mësimore të sugjeruara në program, nxënësi dëgjon dhe punon (u përgjigjet pyetjeve, tregon përmbajtjen, ndan në pjesë, jep mendimet e tij, shpreh pëlqimet e tij për ngjarjet, personazhet etj.) me tekste të cilat janë të përshtatshme për moshën e tij si: përralla, fabula, biseda, tregime, ndodhi personale, emisione televizive, shfaqje për fëmijë, rregulla praktike, teatër me kukulla etj. Ai, gjithashtu, merr njohuritë e mëposhtme:</p>	

<ul style="list-style-type: none"> - Tregimi i përmbajtjes duke e ilustruar me detaje dhe ilustrime nga teksti; - Dallimi e disa detajeve interesante gjatë të dëgjuarit. 	dëgjuarit.
Vlerat dhe qëndrimet	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerëson kontributit e të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre; - shfaq vullnet dhe besim gjatë kryerjes së detyrave; - ka tolerancë dhe respekt për kulturën dhe gjuhën e tjetrit. 	

KOMPETENCA: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Përshkrimi i tematikave të kompetencës

Nxënësi shqipton saktë dhe me intonacionin e duhur fjalët dhe fjalitë. Ai shpreh saktë dhe kuptueshëm mendimet e tij për një temë ose tekst të përshtatshëm për moshën, shoqëron të folurin edhe me elemente joverbale, bashkëpunon në grup, si dhe merr pjesë në lojë me role.

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka etj.;

<ul style="list-style-type: none"> - diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta; - përgatit materiale për organizimin e shfaqjeve dhe ekspozitave në klasë; - merr pjesë në lojë me role. 	
Njohuritë	Shkathtësitë
<p>Njohuritë për klasën përgatitore</p> <p>Nëpërmjet bisedave të përditshme tematike, të përshtatshme për moshën 5-6 vjeç, fëmija fiton njohuri për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullat e thjeshta të të folurit. 	<p>Rregullat dhe organizimi i të folurit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë; - shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, pyet, sqaron, kërkon ndjesë, falenderon dhe u përgjigjet pyetjeve; - përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve (p.sh., <i>tregon pse një objekt i sjellë nga shtëpia është shumë i rëndësishëm për të</i>); - reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendsh; - shpreh emocione dhe ndjesi të ndryshme me anë të pantomimës, ose ndërton histori mbi bazën e ilustrimeve dhe
<p>Njohuritë për klasën e parë</p> <p>Nëpërmjet bashkëbisedimeve dhe diskutimeve rreth tematikave të përshtatshme për moshën e nxënësit si: <i>pëlqimet dhe interesat e fëmijëve, familja, shokët dhe shoqet, lojërat, pushimet etj.</i>, ai fiton njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullat e thjeshta të të folurit: qartësia, volumi i zërit, intonacioni (si e bëjmë zërin, kur pyesim) pozicioni i trupit gjatë kohës që flasim. - Rregullat e lojës me role. 	

<p>Njohuritë për klasën e dytë</p> <p>Nëpërmjet bashkëbisedimeve dhe diskutimeve rreth temave të përshtatshme për moshën e nxënësit si: <i>natyra përreth, kafshët shtëpiake, qyteti ose fshati im, ngjarjet interesante në jetë, festat lokale, kompjuteri dhe televizori etj.</i>, ai fiton njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teknikat e thjeshta të recitimit. - Rregullat e të folurit gjatë punës në grupe të vogla. 	<p>figurave të dhëna.</p> <p>Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - merr pjesë në lojë me role (me ndihmën e mësuesit ose të një të rrituri) dhe shpreh opinionet e tij rreth interpretimit të shokëve dhe shoqeve të klasës; - përdor gjatë prezantimeve të tij edhe elemente të tilla si: foto dhe piktura; - pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë (kryesisht brenda klasës).
<p>Vlerat dhe qëndrimet</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi siguri, kur flet në klasë, shkollë, mes shokëve dhe në shtëpi; - përzgjedh fjalorin e duhur gjatë të folurit (nuk fyen të tjerët, përdor fjalët dhe shprehjet e mirësjelljes); - shoqëron të folurin me shprehjen e duhur të fytyrës dhe gjestet e përshtatshme; - është aktiv në diskutime, në punë në grup ose në veprimtari të tjera të klasës ose shkollës; - shfaq iniciativë ose nxit të tjerët të bashkëbisedojnë për tema të ndryshme që kanë lidhje me karakteristikat dhe zhvillimin moshor të tyre. 	

KOMPETENCA: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Përshkrimi i tematikave të kompetencës

Nxënësi lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekste të thjeshta letrare dhe joletrare. Ai përdor strategji të thjeshta për të kuptuar tekstin si: lidh tekstin me njohuritë e mëparshme, rilexon, pyet rreth paqartësive, mban shënime, bën nënvizime etj. Nxënësi demonstroi kuptimin e tekstit duke treguar brendinë dhe ngjarjet kryesore. Nxënësi, gjithashtu, bën konkluzione të thjeshta dhe jep mendimet e tij rreth tekstit që lexon.

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- përdor strategjitë e duhura për të lexuar tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë dhe paragrafin;
- lexon me zë një tekst të shkurtër dhe tregon funksionin e pjesëve plotësuese të tekstit (p.sh., foto, vizatim, pamje etj.);
- tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit ose parafrazon tekstin;
- jep përshtypjet e veta në lidhje me një tekst të shkurtër letrar (poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula) dhe joletrar (si p.sh., kalendar, fjalor i thjeshtë).

Njohuritë

Shkathtësitë

<p>Njohuritë për klasën përgatitore</p> <p>Nëpërmjet përrallave, tregimeve, kartelave me fjalë dhe figurave që emërtojnë objekte të ndryshme, fëmija fiton njohuritë në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkronjat e mëdha të shtypit dhe tingujt e gjuhës shqipe - Fjalët më të përdorura në klasë, në shkollë (kopsht¹), në familje dhe në mjedisin që e rrethon. - Përdorim tekstesh letrare: përralla të shkurtra, tregime me figura, poezi të thjeshta - Përdorim tekstesh joletrare: kartolina, revista për fëmijë. 	<p>Të lexuarit fillestar²</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - emërton shkronjat e alfabetit; - dallon shkronjat e mëdha nga shkronjat e vogla; - dallon zanoret dhe bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe; - përdor lidhjen mes shkronjës dhe tingullit për të lexuar dhe kuptuar fjalë të reja; - shqipton drejt tingujt, rrokjet dhe fjalët; - lexon rreth 50-70 fjalë në minutë në klasën e parë dhe 70-90 fjalë në minutë në klasën e dytë; - identifikon tiparet dalluese të një fjalie si: shkronja e madhe në fillim të saj, shenja e pikësimit në fund. <p>Të lexuarit për të kuptuar tekstin³</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;
<p>Njohuritë për klasën e parë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkronjat e alfabetit dhe tingujt (të mëdha e të vogla) - Zanore - Bashkëtingëllore - Rrokje - Fjalë 	

¹ Bëhet fjalë për rastet kur klasat përgatitore hapen brenda mjediseve të kopshteve të fëmijëve.

² Aftësi dhe shkathtësi për klasën përgatitore, klasën e parë, të dytë dhe të tretë.

³ Këto aftësi dhe shkathtësi janë të përbashkëta për tekstet letrare dhe joletrare.

<ul style="list-style-type: none"> - Tipare dalluese të fjalisë (fillimi me shkronjë të madhe dhe shenja e pikësimit në fund) - Studim tekstesh letrare: përralla të shkurtra, fabula, tregime me figura, gjëgjëza, poezi të thjeshta. - Studim tekstesh joletrare: kartolina, letra të thjeshta, rregulla të thjeshta praktike, orari i mësimëve. - Njohuri të thjeshta për tiparet e teksteve të mësipërme. 	
<p>Njohuritë për klasën e dytë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studim tekstesh letrare: përralla, fabula, tregime, gjëgjëza, poezi. - Njohuri të thjeshta e të përgjithshme për tiparet e: <ul style="list-style-type: none"> • përrallave; • fabulave; • tregimeve; • gjëgjëzave; • poezive (p.sh., shkruhen në vargje, strofa). - Njohuri për elementet e teksteve si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu. - Studim tekstesh joletrare: kalendarë të thjeshtë, rregulla praktike, kartolina, letra, fjalorë të thjeshtë, revista për 	<ul style="list-style-type: none"> - pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të (<i>Ku? Kur? Pse? Si ndodh kjo? Çfarë do të thotë?</i>); - rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë atë (kur është e nevojshme); - nënvizon gjatë leximit pjesët më të rëndësishme (me ndihmën e mësuesit); - tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar: <i>duke ritreguar shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë; duke përmendur çështjet kryesore; duke dhënë shembuj ose ilustrime nga teksti;</i> - lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me udhëtime, me përvoja personale (<i>dalja e një dhëmbi të ri, marrja e një kafshë shtëpiake në shtëpi</i>) me ngjarje nga jeta e tyre etj. (<i>A ka ndodhur edhe në jetën tuaj diçka e tillë? Çfarë ju kujton kjo histori?</i>) ose me tekste të lexuara më parë (<i>A ka ngjashmëri ky tregim me tregimin... që lexuam javës që shkoi? Çfarë keni të përbashkët ju me personazhin e tregimit? Çfarë ju kujton kjo ngjarje, ose ky personazh?</i>); - shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që

fëmijë.

- Njohuri të thjeshta për elementet e një kalendari, letre drejtuar një të afërmi, kartoline (frazat hyrëse, urimin dhe dërguesin e kartolinës etj.).

lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit (*Si ndjeheni pasi keni lexuar këtë përrallë? A do donit të përfundonte ndryshe? Çfarë do të kishit bërë ju, në një rast të tillë?*);

Të lexuarit e teksteve letrare

Nxënësi:

- lexon poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula, gjëgjëza etj.;
- përcakton dy-tre tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive;
- përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara;
- dallon elemente të tekstit, të tilla, si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu;
- tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;
- krahason poezinë me gjëgjëzën, përrallën me tregimin.

Të lexuarit e teksteve joletrare

Nxënësi:

- lexon tekste joletrare si: ditar, kalendar i thjeshtë, kartolina,

	<p>letra, fjalorë të thjeshtë, revista për fëmijë etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> - veçon disa elemente të teksteve si: titujt, kapitujt dhe ilustrimet si p.sh. <i>në një kalendar dallon vitin, muajt, ditët, në një kartolinë dallojnë frazat hyrëse, urimin dhe dërguesin e kartolinës etj.</i>; - komenton një ilustrim të një teksti.
<p>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mban trupin në një qëndrim të përshtatshëm dhe librin në pozicionin e duhur gjatë kohës që lexon; - tregon interes dhe dëshirë për të lexuar; - shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit; - ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit; - pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë. 	

Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Përshkrimi i tematikave të kompetencës

Nxënësi shkruan saktë dhe pa gabime drejtshkrimore tekste të thjeshta. Ai mbledh informacion nga burime të ndryshme para se të shkruajë kartolina, letra, plane të thjeshta, përshkrime etj. Me ndihmën e mësuesit rishikon tekstin e shkruar për të shmangur gabimet drejtshkrimore.

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan për të komunikuar idetë e veta të tjerët nëpërmjet fjalëve, fjalive etj.; - shkruan tekste të thjeshta (urim, letër, kartolinë) sipas modeleve të dhëna. 	
Njohuritë	Shkathësitë
<p>Njohuritë për klasën përgatitore</p> <p>Fëmija fiton njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kopjimi/ shkrimi i shkronjave kapitale të gjuhës shqipe - Kopjimi/ shkrimi i fjalëve 2-3 rrokëshe <p>Shkrimi i një kartoline ose urimi të thjeshtë me ndihmën e të rriturit.</p>	<p>Shkrimi i dorës</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe shkruan shkronjat e gjuhës shqipe, të shtypit dhe të dorës; - tregon me saktësi lidhjen shkronjë- tingull; - respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive; - plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve ose fjalive; - shkruan fjalë me tri - katër rrokje; - kopjon pjesë që kanë dialog, deri në 3-4 fjali; - shkruajnë fjalë dhe fjali me të diktuar; - u përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta. <p>Planifikimi, organizimi, rishikimi dhe redaktimi i të shkruarit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pyet për t'u sqaruar rreth tekstit që do të shkruajë;
<p>Njohuritë për klasën e parë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkrimi i shkronjave (të dorës dhe të shtypit) të gjuhës shqipe. - Shkrimi i fjalëve 3-4 rrokëshe. - Shkrimi i fjalive dhe vendosja e shenjës së pikësimit në fund të saj. - Shkrimi i diktimeve (me ndihmën e mësuesit). - Shkrimi i një kartoline ose urimi sipas modeleve të dhëna. - Shkrimi i tregimeve të thjeshta nisur nga disa ilustrime. 	

<p>Njohuritë për klasën e dytë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diktime - Përshkrime të thjeshta të një pikturë ose fotografie. - Përshkrime të thjeshta të një personazhi. - Përshkrime të thjeshta për një njeri të afërm, një shok ose kafshë shtëpiake. - Rrëfim i një historie personale (gjysmë faqe). - Shkrimi i tregimeve të thjeshta nisur nga disa ilustrime. - Shkrimi i një kartoline. - Shkrimi i një letre të thjeshtë drejtuar një shoku ose shoqeje. - Shkrimi i një urimi për një ditëlindje ose me rastin e një feste. - Shkrimi i një plani të thjeshtë ditor. 	<ul style="list-style-type: none"> - studion modele të gatshme të punëve me shkrim (p.sh., modele kartolinash, letrash, urimesh). - shkruan për tema të përshtatshme për moshën e tij; - shkruan një tekst të shkurtër (gjysmë faqe për një temë të caktuar); - bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses. <p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan tregime të thjeshta nisur nga figurat e dhëna; - përshkruan me fjalët e tij si e kupton një pikturë, një pamje apo një fotografi; - shkruan hyrje dhe mbyllje të tjera të një tregimi ose përralle; - përshkruan shokë, miq, të afërm, personazhe, objekte, sende e kafshë të dashura për të; - rrëfen histori e përvoja personale duke u ndihmuar nga pyetjet: <i>Kush? Cili? Çfarë? Si? Kur? Ku?</i>. <p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p>
---	---

	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan tekste të shkurtra si: një urim, një kartolinë, një letër drejtuar një shoku duke përdorur një model të thjeshtë; - harton një plan të thjeshtë të regjimit ditor.
<p>Vlerat dhe qëndrimet</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mban gjatë të shkruarit pozicionin e duhur të trupit, dorës, fletores ose fletës ku shkruan; - shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; - respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; - vlerëson punët e të tjerëve; - bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. 	

Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës

Përshkrimi i tematikave të kompetencës

Nxënësi dallon fjalitë në një tekst. Ai zhvendos, shton ose heq fjalë në një fjali pa e prishur kuptimin e saj. Nxënësi dallon fjalitë pyetëse dhe dëftore, pohore dhe mohore si dhe vendos shenjat e pikësimit në fund të tyre. Ai nis të dallojë emrin, mbiemrin, foljen, përemrin dhe numërorin. Nxënësi përdor drejt shkronjën e madhe (disa raste të përdorimit të saj), ndan si duhet fjalët në fund të rreshtit, si dhe shkruan saktë numërorët 1-20.

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore dhe pyetëse, duke respektuar shenjat e pikësimit;
- dallon emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh në numrin njëjës dhe shumës;
- zgjedhon folje të rregullta në kohën e tashme, sipas modeleve të dhëna;
- dallon mbiemrin si fjalë, që tregon cilësi të emrit;
- gjen dhe formon fjali me përemra vetorë dhe me numërorë.

Njohuritë

Shkathësitë

<p>Njohuritë për klasën e parë</p> <p>Fjalìa, fjala, rrokje, tingull</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndarja e fjalisë në fjalë, fjalës në rrokje, rrokjes në tinguj; - Fjalët që tregojnë veprime (foljet). - Fjalët që tregojnë njerëz, sende, vende, kafshë (emra). - Fjalët që tregojnë cilësi të njerëzve, sendeve, kafshëve (mbiemrat). - Përdorimi i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë, në titullin e një pjese, te emrat e njerëzve dhe kafshëve. - Përdorimi i pikës dhe i pikëpyetjes në fund të fjalisë. 	<p>a) Sintaksë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon fjalitë në një tekst; - dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore dhe pyetëse, duke respektuar shenjat e pikësimit; - zhvendos fjalët në një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj; - shton dhe heq fjalë në një fjali të thjeshtë pa prishur kuptimin e saj. <p>b) Morfologji</p> <p>Nxënësi:</p>
<p>Njohuritë për klasën e dytë</p> <p>a) Sintaksë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tiparet e fjalisë. - Fjalìa dëftore dhe pyetëse (tregojmë ose pyesim) - Zhvendosje e fjalëve në fjali, pa e prishur kuptimin e saj. - Plotësime ose heqje fjalësh në fjali, pa e prishur kuptimin e saj. <p>b) Morfologji</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohuri të thjeshta për emrin. 	<p>Emri</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon fjalët që tregojnë emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh; - dallon emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullore (në mënyrë intuitive); - dallon emrin në numrin njëjës dhe në numrin shumës (në mënyrë intuitive); <p>Folja</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon fjalët që tregojnë veprim (me ndihmën e mësuesit); - dallon kohën e kryerjes së një veprimi, nisur nga koncepti

<ul style="list-style-type: none"> - Gjinia e emrit (në mënyrë intuitive). - Numri i emrit (në mënyrë intuitive). <p>Folja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohuri të thjeshta për foljen. - Koha e kryerjes së një veprimi, nisur nga koncepti kohë: dje-sot-nesër. - Zgjedhimi i foljeve kam, jam në kohën e tashme. - Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e tashme sipas modeleve të dhëna. <p>Mbiemri</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohuri të thjeshta për mbiemrin, si fjalë që tregon cilësi të emrave. <p>Përemri</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përemri vetor. <p>Numërori</p> <ul style="list-style-type: none"> - Numërori <p>c) Drejtshkrim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i shenjave të pikësimit (pikë dhe pikëpyetje në fund të fjalisë). 	<p>kohë: dje-sot-nesër;</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjedhon folje të rregullta në kohën e tashme sipas modeleve të dhëna; - zgjedhon foljet kam, jam në kohën e tashme; <p>Mbiemri</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon fjalët që tregojnë cilësi të emrit (me ndihmën e mësuesit); <p>Përemri</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon përemrat vetorë: unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato. <p>Numërori</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon numërorët 1-20 si fjalë që tregojnë sasi. <p>c) Drejtshkrim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor drejt pikën dhe pikëpyetjen në fund të fjalisë; - përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë; - përdor drejt shkronjën e madhe për emra njerëzish, vendesh dhe kafshësh; - ndan si duhet fjalët në fund të rreshtit;
---	---

<ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë. - Përdorimi i shkronjës së madhe për emrat e njerëzve, vendeve (qyteteve, fshatrave, shteteve) dhe kafshësh; - Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit. - Shkrimi i numërorëve 1-20. <p>d) Leksikologji dhe semantikë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sinonimet (<i>fjalë me kuptim të afërt ose të njëjtë</i>). - Antonimet (<i>fjalë me kuptim të afërt ose të kundërt</i>). 	<ul style="list-style-type: none"> - shkruan me fjalë numërorët 1-20. <p>d) Leksikologji dhe semantikë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjen fjalë sinonimike për një grup fjalësh të dhëna (<i>gjeni fjalë me kuptim të afërt ose të njëjtë</i>.); - zëvendëson në një tekst disa fjalë me sinonimet e tyre (të dhëna); - gjen fjalë antonimike për një grup fjalësh të dhëna (<i>gjeni fjalë me kuptim të afërt ose të kundërt</i>).
Vlerat dhe qëndrimet	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij; - demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; - demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; - respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 	



SHKALLA 2
KLASA 3-5

Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Përshkrimi i tematikave të kompetencës

Nxënësi demonstroi qëndrime dhe sjellje të përshtatshme gjatë të dëgjuarit si: vëmendje, kontakt me sy, mbajtje të trupit në pozicion korrekt. Ai përdor strategji të shumta (para, gjatë dhe pas dëgjimit), në mënyrë që të kuptojë tekstin. Nxënësi gjykon dhe vlerëson tekstin e dëgjuar duke dhënë mendimet dhe opinionet e tij. Ai dallon ndjenjat dhe emocionet e folësit.

Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të dëgjuarit

Nxënësi:

- kupton një tekst që dëgjon dhe përgjigjet në mënyrën e duhur në situata dhe për qëllime të ndryshme;
- komunikon me të tjerët për përmbajtjen dhe qëllimin e teksteve;
- veçon informacionin kryesor të bisedave të thjeshta ose tregimeve dhe diskuton rreth tij.

Njohuritë	Shkathtësitë
<p>Njohuritë për klasën e tretë</p> <p>Gjatë orëve mësimore të sugjeruara në program, nxënësi dëgjon dhe punon (ritregon, ndan në pjesë, jep mendimet e tij) me tekste të cilat janë të përshtatshme për moshën e tij si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përralla, fabula; - rrëfime ose ndodhi personale; - tregime; - poezi; - dramatizime të ndryshme; - shfaqje për fëmijë ose tekste të tjera mediatike; - udhëzime të thjeshta. <p>Ai, gjithashtu, merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Struktura e një rrëfimi, tregimi, përralle etj. (hyrja, zhvillimi, mbyllja). - Përcaktimi i ideve ose çështjeve kryesore të një teksti. - Dallimi i detajeve kyçe në një tekst. 	<p>Rregullat e të dëgjuarit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - sheh në sy personin gjatë kohës që flet; - mban trupin në një pozicion korrekt; - është i vëmendshëm ndaj tekstit që dëgjon; - përfshihet dhe duke shfaq interes ndaj të tjerëve në bashkëbisedime (<i>Mund të më thuash diçka më shumë? Të lutem, ma trego edhe njëherë!</i> etj.). <p>Të dëgjuarit për të kuptuar dhe vlerësuar tekstin</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tregon njohuritë paraprake rreth tekstit që dëgjon; - përcakton qëllimin që ka, kur dëgjon një tekst (<i>dëgjon që të hartojë një përmbledhje, dëgjon që të sqarohet për një detyrë ose veprimtari</i>); - dallon hyrjen, zhvillimin dhe fundin e një historie, përralle ose tregimi; - përmbledh përmbajtjen e tekstit duke e ilustruar me detaje dhe ilustrime nga teksti si: p.sh., <i>përmbledh para një grupi të vogël një episod të një programi televiziv të preferuar ose</i>
<p>Njohuritë për klasën e katërt</p> <p>Gjatë orëve mësimore të sugjeruara në program nxënësi dëgjon dhe punon (ritregon, analizon, jep gjykime të thjeshta) me</p>	

<p>tekste të cilat janë të përshtatshme për moshën e tij si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - poezi, përralla ose fabula; - tregime, teatër me kukulla; - rrëfime personale, anekdota; - udhëzime për kryerjen e një aktiviteti. <p>Ai, gjithashtu, merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmbledhja e një teksti të thjeshtë. - Mënyrat që përdoren për t'u sqaruar rreth kuptimit të një teksti. 	<p><i>përmbledh çështjet kryesore të një pjese letrare që lexohet në klasë etj.</i> (për të treguar që e ka kuptuar tekstin);</p> <ul style="list-style-type: none"> - veçon detajet dhe çështjet kryesore të tekstit që dëgjon; - pyet rreth informacioneve ose ideve që dëgjon nga një prezantim, në mënyrë që të sqarohet dhe të kuptojë tekstin; - parashikon se çfarë do të ndodhë në vijim, kur dëgjon pjesë-pjesë një rrëfim (dëgjim i drejtuar); - mban shënime për çështjet kryesore; - lidh përmbajtjen e një teksti që dëgjon me atë të librave, filmave, videove, shfaqjeve televizive ose pjesëve dramatike që trajtojnë të njëjtën temë;
<p>Njohuritë për klasën e pestë</p> <p>Përveç llojeve të teksteve që përmenden në klasat 3 dhe 4 (natyrisht më komplekse), nxënësi mund të njihet dhe të punojë edhe me tekste si: receta, një projekt shkolle, një ngjarje në shkollë, një tekst shpjegues (si formohen retë, si riciklohen sendet plastike etj.).</p> <p>Ai, gjithashtu, merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbajtja e shënimeve gjatë të dëgjuarit. - Funkzioni i disa elementeve të një teksti si: gjuha e folësit (zgjedhja e fjalëve), toni i zërit, mimika e fytyrës. - Rregullat gjatë të dëgjuarit (mimika, qëndrimi i duhur i 	<ul style="list-style-type: none"> - analizon një tekst dhe shpjegon funksionin që kanë disa elemente e tij si: zgjedhja e fjalëve, toni i zërit, mimika e fytyrës (<i>A ju komunikon toni i zërit të folësit, një mesazh të ndryshëm nga fjalët e tij?</i>); - jep gjykime të thjeshta rreth tekstit; - gjen problemin dhe zgjidhjen që propozohet në një tekst që dëgjon.

<p>trupit, shfaqje e interesit, vënia e vetes në vendin e tjetrit)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikimi i problemit dhe zgjidhjes në një tekst. 	
<p>Vlerat dhe qëndrimet</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerëson kontributit e të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre; - demonstroi vullnet gjatë kryerjes së detyrave; - shfaq tolerancë dhe respekt për kulturën dhe gjuhën e tjetrit; - shfaq empati ndaj të tjerëve. 	

KOMPETENCA: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Përshkrimi i tematikave të kompetencës

Nxënësi shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. Ai përcakton qëllimin e të folurit, shpreh saktë dhe kuptueshëm mendimet e tij, shoqëron të folurin edhe me elemente joverbale, bashkëpunon në mënyrë aktive në grup.

Rezultatet e të nxënësve për këtë kompetencë

Nxënësi:

- merr pjesë në diskutime për tema të përshtatshme për moshën e tij;
- përgatit materiale për organizimin e shfaqjeve në klasë dhe paraqitjeve para ekranit;

- shfaq prirjet e veta në lojërat e thjeshta skenike.	
Njohuritë	Shkathtësitë
<p>Njohuritë për klasën e tretë</p> <p>Duke folur për tematika të tilla si: <i>marrëdhëniet me prindërit, gjyshërit, vëllezërit, motrat dhe njerëzit të tjerë të dashur për ta; mbresat e udhëtimeve; argëtimet, festat etj.</i>, nxënësi merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Qartësia, intonacioni dhe theksi i duhur, gjestet, shprehja ose mimika e fytyrës gjatë të folurit. - Mënyrat dhe format e shprehjes së mendimeve, pëlqimeve dhe përjetimeve të tij (<i>përmbledhje, rrëfime, lojë me kukulla, dramatizime, recitime etj.</i>). - Teknikat e recitimit dhe imitimet e zërit të një personazhi të një tregimi dhe të përralle ose zërit të një personi që flet në një sigël, reklamë, batutë, film etj. 	<p>Rregullat dhe organizimi i të folurit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - flet duke përdorur cilësitë e duhura të zërit si: theksi, ritmi, lartësia e zërit, intonacioni; - tregon se kuptimi përcillet jo vetëm nëpërmjet fjalëve, por edhe me ndihmën e ritmit, tonit dhe intonacionit të zërit, theksit (p.sh., gjatë leximit shprehës të poezive, tregimeve etj.); - përcakton qëllimin që ka, kur flet ose bashkëbisedon me të tjerët si p.sh.: <i>justifikon opinionet dhe mendimet e tij në një diskutim në grup; ofron zgjidhje rreth një problemi; jep informacione rreth një teme etj.</i>; - shpreh opinionet, mendimet dhe ndjesitë e tij me një gjuhë të saktë e të kuptueshme; - bën një prezantim të thjeshtë për të treguar një përvojë ose eksperiencë të tijën, duke e shoqëruar prezantimin me mjete pamore si: poster, harta, lista, foto etj., kur është e mundur edhe me ndihmën e kompjuterit;
<p>Njohuritë për klasën e katërt</p> <p>Duke folur për tematika të tilla si: <i>respekti për natyrën, kujdesi për kafshët shtëpiake, leximet gjatë pushimeve, ngjarje të veçanta në jetën e secilit, veprimtaritë sportive etj.</i> (nxënësi edhe</p>	

<p>mund të sugjerojë vetë tematika për diskutimi), nxënësi merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rrjedhshmëria gjatë të folurit. - Interpretimi me ndjenjë i pjesëve të ndryshme. - Rregulla të thjeshta për zgjedhjen e fjalëve dhe frazave të duhura për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve. 	<ul style="list-style-type: none"> - shpreh ndjenjat dhe emocionet e tij me një fjalor të pasur duke përdorur shprehje frazeologjike, fjalë të urta, fjalë me kuptim të figurshëm etj.; - reciton pjesë të mësuara përmendësh; - përdor mirë gjuhën standarde gjatë të folurit. <p>Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup</p>
<p>Njohuritë për klasën e pestë</p> <p>Duke folur për tematika të tilla si: <i>bota magjike e teatrit dhe e filmi, shkolla, njerëzit që kanë nevojë dhe ndihma që mund të ofrohet për ta, koha e lirë etj.</i>, nxënësi merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e një prezantimi të thjeshtë; - Përdorimi i gjuhës standarde gjatë të folurit; - Mënyrat e mbështetjes së ideve të të tjerëve gjatë diskutimeve në grup. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - merr pjesë në diskutime, prezantime, shfaqje, debate etj., për tema të ndryshme; - mbështet dhe vlerëson këndvështrimet e të tjerëve gjatë diskutimeve dhe bashkëpunimit në grup (çift, grupe të vogla, grupe të mëdha).
<p>Vlerat dhe qëndrimet</p>	
<p>Nxënësi:</p>	

- merr pjesë në diskutime në grup duke pyetur, duke u përgjigjur dhe bashkëpunuar me të tjerët;
- flet në përputhje me normat e vlerat shoqërore, në situata të ndryshme komunikimi në klasë;
- përdor në mënyrë korrekte gjatë të folurit elementet joverbale si: gjestet, mimika, kontakti me sy;
- shfaq me siguri e besim në vetvete mendimet, përvojat dhe argumentet e tij;
- nxit diskutimet në grup duke ofruar kontributin e tij;
- diskuton bashkërisht në grup për të arritur objektivin e një detyre duke ofruar idetë, zgjidhjet dhe këndvështrimet e tij.

KOMPETENCA: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Përshkrimi i tematikave të kompetencës

Nxënësi zgjedh tekstin që lexon në varësi të qëllimit që ka. Ai përdor disa strategji para, gjatë dhe pas leximit për të kuptuar tekstin. Nxënësi demonstroi të kuptuarit e tekstit duke treguar brendinë dhe duke e ilustruar atë me fragmente dhe detaje nga teksti. Nxënësi gjykon me argumente idetë dhe informacionin e tekstit, dallon elemente të formës dhe strukturës së teksteve, krahason personazhe, ide, informacione etj. Ai zbulon ngjashmëritë dhe ndryshimet mes teksteve.

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- përdor strategjitë e të lexuarit për të kuptuar tekste letrare (poezi, këngë popullore, poema, fabula, tregime, novela, legjenda, përralla, mite, romane për fëmijë, drama) apo joletrare (udhëzime të shkurtra, sqarime, argumente, artikuj në gazeta dhe revista për fëmijë);
- identifikon pjesët themelore të ngjarjeve apo të tregimeve të lexuara me zë të lartë, duke përdorur fjalë të rëndësishme ose objekte pamore (fotografi, vizatime, pamje etj.);

<ul style="list-style-type: none"> - dallon temën dhe idetë kryesore në tekste letrare si: <i>poezi, këngë popullore, poema, fabula, tregime, novela, legjenda, përralla, mite, romane për fëmijë, drama</i>; - interpreton dhe analizon elemente të thjeshta në një tekst si: subjekti, personazhi kryesor, personazhe dytësore, mjedisi ose hapësira, ku zhvillohen ngjarjet; - dallon gjuhën e figurshme nga gjuha jo e figurshme; - gjen në një tekst: <i>rimën, personifikimin, krahasimin, hiperbolën, epitetin</i>; - dallon dhe analizon temën, idetë, strukturën dhe elementet grafike të tekstit joletrar (letër formale, udhëzim, njoftim etj.). 	
Njohuritë	Shkathësitë
<p>Njohuritë për klasën e tretë</p> <p>Studim tekstesh letrare: poezi të thjeshta, gjëegjëza, fabula, përralla, tregime etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krahasime mes përrallës dhe fabulës - Brendia ose përmbajtja e një teksti. - Struktura e tekstit letrar (hyrja, zhvillimi, mbyllja). - Personazhet e tekstit. - Koha dhe mjedisi ku zhvillohen ngjarjet. - Njohuri për elementet pamore të teksteve: foto, ilustrime (funksionet e tyre). <p>Studim tekstesh jo letrare: revista për fëmijë, udhëzime të</p>	<p>Të lexuarit për të kuptuar tekstin</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh tekstin që lexon në varësi të qëllimit që ka si p.sh.: një fjalor për të sqaruar e gjetur kuptimin e një fjale, një enciklopedi për fëmijë që të marrë informacion, një biografi për t'u njohur me jetën dhe veprën e një autori, një tregim për kënaqësi estetike dhe për t'u argëtuar etj.; - lexon rrjedhshëm tekstin; - përdor disa strategji për të kuptuar tekstin (para, gjatë dhe pas leximit) si p.sh.: <i>aktivizon njohuritë e mëparshme nëpërmjet një diskutimi në grup; i rikthehet leximit të tekstit</i>

<p>thjeshta, porosi, fletë ditari.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Struktura e tekstit joletrar. - Tipare të thjeshta të një udhëzimi, porosie, flete ditari. - Titulli, nëntitujt, ndarja në paragrafë e një teksti. 	<p><i>deri sa ta kuptojë atë; bën pyetje për çështje që nuk i kupton në tekst etj.;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - parashikon se çfarë do të ndodhë në tekst duke u bazuar në atë që ka lexuar më parë (lexim i drejtuar); - kërkon dhe gjen në fjalor kuptimin e fjalëve të panjohura që lexon; - u përgjigjet pyetjeve të mësuesit rreth brendisë së tekstit; - ritregon pjesën që lexon; - përmbledh idetë kryesore duke i ilustruar me fragmente dhe detaje nga teksti; - lidh idetë dhe informacionin e tekstit me njohuritë, përvojën dhe leximet e mëparshme ose dukuri të jetës së përditshme (<i>A ju kujton ky personazh diçka nga jeta juaj?;</i> - gjykon me argumente të thjeshta idetë dhe informacionin e tekstit (<i>A mendoni se ky veprim zbulon diçka nga karakteri i personazhit? Ku e mbështetni mendimin tuaj?;</i> - krahason në një tekst dy ose më shumë ide, koncepte, detaje etj.; - dallon disa elemente të formës dhe të strukturës së teksteve dhe sqaron funksionin e tyre; - zbulon ngjashmëritë dhe ndryshimet mes teksteve të
<p>Njohuritë për klasën e katërt</p> <p>Studim tekstesh letrare: poezi të thjeshta, këngë popullore, fabula, përralla, tregime, anekdota.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Renditja e ngjarjeve në një tekst. - Analiza e personazheve, tiparet e jashtme, veprimet, ndjenjat. - Rima dhe strofa në poezi (dallimi). - Tiparet e thjeshta të një këngë popullore për fëmijë. - Krahasim mes një përralle, fabule dhe tregimi. - Krahasim mes një tregimi, një filmi ose teatri me kukulla. <p>Studim tekstesh jo letrare: fletë ditari, letra, revista, shkrime në gazeta për fëmijë, enciklopedi për fëmijë, atlase, udhëzime.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Çështjet kryesore në një tekst. - Tipare të thjeshta të një ditari, udhëzimi, enciklopedie për fëmijë. 	

<ul style="list-style-type: none"> - Njohuri për elementet pamore të teksteve: lista, tabela, harta. 	<p>ndryshme që trajtojnë të njëjtën tematikë.</p>
<p>Njohuritë për klasën e pestë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Strategjitë e thjeshta të të lexuarit. - Përdorimi i fjalorit <p>Studim tekstesh letrare: poezi, këngë popullore, poema, fabula, tregime, novela, legjenda, përralla, mite, romane për fëmijë, tekste të thjeshta dramatike.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tiparet e thjeshta të një legjende dhe romani për fëmijë. - Tema ose çështjet kryesore. - Analizë e subjektit, mjedisit dhe kohës në një tekst. - Analizë personazhesh duke u bazuar të fjalët, përshkrimet e veprimet e tyre, marrëdhëniet me personazhet e tjera. - Personazhet kryesore dhe dytësore. - Epiteti, krahasimi, personifikimi, hiperbola. - Rima dhe strofa. - Tiparet e një teksti të thjeshtë dramatik: aktet, personazhet, dialogjet, monologjet, didaskalitë. <p>Studim tekstesh jo letrare: udhëzime të shkurtra, sqarime,</p>	<p>Të lexuarit e teksteve letrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon tekste letrare si: poezi, këngë popullore, poema, fabula, tregime, novela, legjenda, përralla, mite, romane për fëmijë, tekste të thjeshta dramatike; - u përgjigjet pyetjeve (<i>Kush? Çfarë? Kur? Ku? Pse?</i>) në lidhje me ngjarjet që ndodhin në tregim, përrallë, fabul, legjendë etj; - dallon temat ose idetë kryesore në tekstet letrare (poezi, prozë ose tekste dramatike); - rilexon dhe tregon pjesën që i pëlqen më shumë dhe është më e këndshëm për ta, si dhe argumenton pëlqimin e tij; - analizon subjektin, mjedisin ose hapësirën ku zhvillohen ngjarjet në një tekst; - analizon personazhet duke u mbështetur në: <ul style="list-style-type: none"> • dialogjet, përshkrimet dhe veprimet e tyre; • marrëdhëniet me personazhet e tjera. - gjen në një tekst: rimën, personifikimin, krahasimin, hiperbolën, epitetin;

<p>letra, njoftime, atlas, artikuj në gazeta dhe revista për fëmijë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tema ose çështjet kryesore. <p>Tipare të thjeshta të një udhëzimi, sqarimi, letre, njoftimi, atlas.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - dallon disa elemente të tekstit dramatik si: skenat, aktet, grupin e personazheve, fjalët e personazheve, didaskalitë; - krahason tregimin me përrallën dhe fabulën; - diskuton me të tjerët dhe jep opinionet e tij për librat që lexon për leximet jashtë klase dhe lexime të tjera; <p>Të lexuarit e teksteve joletrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon tekste joletrare si: udhëzime të shkurtra, shënime (porosi), sqarime, njoftime, letra formale, artikuj në gazeta dhe në revista për fëmijë; - dallon temat ose idetë kryesore në tekstet joletrare; - analizon strukturën e një teksti joletrar; - kupton funksionet e elementeve grafike të disa teksteve si: hartat, tabelat, ilustrimet.
<p>Vlerat dhe qëndrimet</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - është i motivuar për të lexuar për kënaqësi dhe informacion; - është i vëmendshëm gjatë të lexuarit; - respekton dhe pranon mendimin e tjetrit; 	

- shfaq empati;
- respekton etikën gjatë komunikimit personal dhe në grup;
- vlerëson kontributin e të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre;
- shfaq vetëbesim dhe vetëvlerësim;
- demonstroi vullnet gjatë kryerjes së detyrave;
- respekton kulturën dhe gjuhën e tjetrit;
- mban trupin në një qëndrim të përshtatshëm dhe librin në pozicionin e duhur gjatë kohës që lexon.

KOMPETENCA: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Përshkrimi i tematikave të kompetencës

Nxënësipërcakton qëllimin dhe temën për të realizuar në mënyrën dhe formën e duhur punën me shkrim. Ai bën një punë përgatitore për të mbledhur informacion nga burime të ndryshme. Nxënësi shkruan ekste për qëllime të ndryshme personale dhe funksionale, përqendrohet në temën që do të trajtojë, lidh logjikisht fjalitë në paragraf e paragrafët mes tyre dhe mbështet idetë me argumente të thjeshta ose shembuj të ndryshëm. Ai përdor mirë gjatë të shkruarit gjuhën standarde. Nxënësi përmirëson dhe korrigjon formën dhe përmbajtjen e punëve të tij me shkrim.

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- shkruan tekste duke u përqendruar në temën që do të trajtojë duke lidhur logjikisht fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre;

<ul style="list-style-type: none"> - shkruan për qëllime dhe audienca të caktuara tekste si: poster i thjeshtë, reklamë, një menu etj.; - identifikon (me ndihmën e mësuesit) në punët e tij elementet që kanë nevojë për përmirësime si p.sh., përdorimin e gjuhës dhe i redakton ato. 	
Njohuritë	Shkathtësitë
<p>Njohuritë për klasën e tretë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diktime <p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkrime të njerëzve të dashur, të heronjve të preferuar të librave ose të filmave, të natyrës, të lojërave etj. - Shkrime hyrjesh ose mbylljesh të tjera të përrallave ose tregimeve të lexuara. - Rrëfime të subjektit të një filmi ose libri; - Rrëfime të ngjarjeve të jetuara, interesante ose të veçanta, në vetën e parë. - Shkrime historish duke u mbështetur në disa foto ose fjalë kyçe. <p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plotësime modelesh (tekste) gjysmë të gatshme. 	<p>Të shkruarit si proces⁴</p> <ul style="list-style-type: none"> - Planifikimi, organizimi, rishikimi dhe redaktimi i të shkruarit <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton qëllimin dhe temën për të realizuar në mënyrën dhe formën e duhur tekstin e shkruar (me ndihmën e mësuesit); - mbledh informacion nga burime të ndryshme duke ndjekur disa strategji të thjeshta si p.sh., studion modele të gatshme tekstesh ose mban shënime nga burimet e shfrytëzuara për punën me shkrim; - shkruan tekste koherente duke u përqendruar në temën që do të trajtojë dhe lidh logjikisht fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre; - mbështet idetë me shembuj të ndryshëm;

⁴Këto aftësi dhe shkathtësi janë të përbashkëta për të gjitha llojet e teksteve që shkruajnë nxënësit.

<ul style="list-style-type: none"> - Shkrime urimesh, kartolinash, letrash falenderimi, ftesa për ditëlindje. - Shkrime planesh të thjeshta për veprimtari me klasën. 	<ul style="list-style-type: none"> - përdor gjuhën për të emocionuar dhe rritur interesin e lexuesit si p.sh., folje për të përshkruar veprime ose sjellje, mbiemra për të cilësuar dhe karakterizuar personazhet etj.; - përdor ligjëratën e drejtë në një tregim për të tipizuar më mirë një personazh;
<p>Njohuritë për klasën e katërt</p> <ul style="list-style-type: none"> - Korrigjimi dhe përmirësimi i të shkruarit (gabimet drejtshkrimore) - Diktimit <p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkrime të shokëve, artistëve ose sportistëve të preferuar. - Rrëfime ngjarjesh rreth botës reale dhe imagjinare si p.sh.: për pushimet, për librat, për universin, për anijet kozmike etj.; - Përshkrime personazhesh duke pasqyruar ndjenjat dhe mendimet, paraqitjen e jashtme dhe veprimet e tyre; - Punë me shkrim duke u mbështetur në imagjinatën e nxitur nga fantazia njerëzore në përralla dhe legjenda etj. <p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkrime ftesash për miqtë dhe shokët. - Informacione të shkurtra p.sh. një informacion të shkurtër 	<ul style="list-style-type: none"> - shton në një tekst një dialog mes personazheve ose një ndodhi të re, një paragraf; - përdor mirë gjuhën standarde; - zbaton rregullat e drejtshkrimit gjatë të shkruarit; - identifikon me ndihmën e mësueses, elementet që kanë nevojë për përmirësime si p.sh., përdorimin e gjuhës (shton dy mbiemra për të përshkruar një personazh); - rishikon dhe përmirëson punët me shkrim për të dhënë më qartë mendimet dhe për të përmirësuar përmbajtjen; - rishikon tekstin që shkruan për të gjetur fjalët, shprehjet ose fjalitë e papërshtatshme dhe për t'i plotësuar me të tjera ato; - korrigjon gabimet drejtshkrimore; - rishikon dhe vlerëson punët e shokëve dhe shoqeve të klasës, me qëllim përmirësimin e tyre. <p>Të shkruarit për qëllime personale</p>

<p>për aktivitetet e klasës.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i një plani javor - të plotësojnë plane veprimtarish argëtuese, sportive dhe artistike që mund të organizojnë klasat e katërta të shkollës. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan natyrën, vendlindjen, fëmijërinë e tij etj.; - përshkruan personazhet duke pasqyruar: ndjenjat dhe mendimet dhe paraqitjen e jashtme; - rrëfen ngjarje, shpreh ndjenja, përcjell ide rreth botës reale dhe imagjinare; - krahason dy- tre tekste të thjeshta letrare që trajtojnë të njëjtën tematikë; - krahason dy personazhe, ngjarje, mjedise nga një tregim, përrallë, fabul, roman për fëmijë etj., duke konkretizuar me shembuj dhe ilustrime nga teksti; - shpreh me shkrim ndjenjat dhe përjetimet që i ngjall një poezi, një tregim etj.
<p>Njohuritë për klasën e pestë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diktimit - Korrigjimi dhe përmirësimi i të shkruarit (gabimet drejtshkrimore, fjalët ose shprehjet e papërshtatshme). <p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkrime të natyrës, vendlindjes, fëmijërisë etj. - Përshkrime personazhesh duke pasqyruar: ndjenjat dhe mendimet dhe paraqitjen e jashtme. - Rrëfime ngjarjesh rreth botës reale dhe imagjinare. - Krahasime të dy- tri teksteve të thjeshta letrare që trajtojnë të njëjtën tematikë. - Krahasime mes dy personazheve ose ngjarjeve nga një tregim, përrallë, fabul, roman për fëmijë etj. - Punë me shkrim ku shprehen ndjenjat dhe përjetimet që ngjall një poezi, një tregim etj. 	<p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan udhëzime, adresa, urime festash, argumente të thjeshta, letër ndjese, plan javor dhe njoftime; - shkruajnë një letër drejtuar p.sh., një redaksie gazete ose reviste për fëmijë, drejtorisë së shkollës; - u përgjigjet pyetësorëve të thjeshtë;

Të shkruarit për qëllime funksionale

- Shkrime adresash, urime festash, njoftimesh të shkurtra.
- Shkrime udhëzimesh dhe argumentesh të thjeshta sipas një modeli të dhënë.
- Shkrimi i një letre ndjese drejtuar një miku ose një të afërmi.
- Shkrimi i një letre drejtuar p.sh., një redaksie gazete ose reviste për fëmijë, drejtorisë së shkollës.
- Plotësimi i pyetësorëve të thjeshtë.

- shkruan duke respektuar strukturën e tekstit që përfshin paraqitjen e çështjes kryesore (hyrje), idetë, argumentet dhe detajet mbështetëse e ilustruese dhe konkluzionet;
- respekton formën ose modelin e përshtatshëm p.sh., gjatë shkrimit të një letre ose njoftimi shkruan formulimet e hapjes e të mbylljes dhe nënshkrimin.

Vlerat dhe qëndrimet

Nxënësi:

- shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit;
- demonstroi imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë të shkruarit;
- punon në mënyrë të pavarur;
- respekton gjuhën shqipe duke shmangur fjalët e huaja gjatë të shkruarit;
- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerëson punët e të tjerëve;
- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre me shkrim.

Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës

Përshkrimi i tematikave të kësaj kompetence

Nxënësit dallon dhe përdor fjali dëftore, pyetëse, nxitëse dhe dëshirore. Ai dallon dhe përdor gjymtyrët kryesore dhe përcaktorin në fjali. Nxënësi dallon emrin, foljen, përemrat, lidhëzat, parafjalët, pashirrrmat si dhe kategoritë kryesore gramatikore të tyre (te fjalët e ndryshueshme). Nxënësi përdor drejt shenjat e pikësimit, shkruan drejt fjalët në ligjëratën e drejtë, përdor saktë shkronjën e madhe etj. Nxënësi dallon pjesët përbërëse të fjalës, fjalët e parme dhe fjalët jo të parme. Nxënësi gjen sinonime dhe antonime për fjalë të caktuara, dallon kuptimet e figurshme të fjalëve si dhe përdor fjalorin për nevojat e tij.

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- dallon dhe përdor drejt lloje të ndryshme fjalish (dëftore, pyetëse, nxitëse dhe dëshirore);
- dallon dhe përdor drejt gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta të fjalisë (kundrinor, rrethnor, përcaktor);
- dallon kategoritë kryesore gramatikore të emrit, foljes, mbiemrit, përemrit, si dhe gjen lidhëzat dhe parafjalët;
- dallon fjalët e parme dhe jo të parme si dhe pjesët përbërëse të fjalëve;
- dallon dhe përdor sinonimet, antonimet, homonimet, fjalët e urta dhe shprehjet frazeologjike.

Njohuritë

Shkathësitë

Njohuri për klasën e tretë

a) Sintaksë

- Teksti (ç'quajmë tekst dhe elementet e tij (fjalitë, paragrafët).
- Struktura e një fjalie të thjeshtë.
- Zhvendosja e fjalëve ose grupeve të fjalëvenë fjali pa e prishur kuptimin e saj.
- Shtime ose heqje fjalësh ose grupe fjalësh në fjali pa e prishur kuptimin e saj.
- Fjalitë dëftore dhe pyetëse.
- Fjalitë pohore dhe mohore.

b) Morfologji

Emri

- Emri, çfarë emërton (njohuri të përgjithshme)
- Emrat e gjinisë mashkullore dhe gjinisë femërore nisur nga mbaresat e tyre.
- Emrat në numrin njëjës dhe në numrin shumës.

Folja

- Folja, çfarë tregon (njohuri të përgjithshme).
- Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e tashme.

a) Sintaksë

Nxënësi:

- ndërton drejt fjali, duke patur si bazë fjalën si njësi leksiko-gramatikore, logjikën e thënies, intonacionin e përfunduar;
- ndërton dhe dallon fjali dëftore, pyetëse, dëshirore, nxitëse;
- dallon grupin foljor dhe grupin emëror;
- dallon kryefjalën e shprehur me emër, përemër, grup emëror;
- formon fjali ku kryefjala të jetë e shprehur me emër, përemër, grup emëror;
- dallon kallëzuesin dhe tregon me se shprehet;
- dallon përcaktorin brenda grupit emëror dhe tregon me se shprehet;
- gjen përcaktorin dhe tregon me se shprehet (emër, mbiemër, përemër, numëror).

b) Morfologji

Nxënësi:

- përcakton klasën e fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme;
- dallon emrat konkretë dhe abstraktë;
- krahason emrat e përgjithshëm me të përveçëm, konkretët me

<ul style="list-style-type: none"> - Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e ardhme. - Zgjedhimi i foljeve në kohën e shkuar. <p>Mbiemri</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbiemri si fjalë që tregon cilësi të emrit. - Mbiemri i nyjshëm dhe i panyjshëm. - Përcaktimi i gjinisë së mbiemrit, ndihmuar nga emri që cilëson. - Numri i mbiemrit, ndihmuar nga emri që cilëson. <p>Përemri</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përemrat vetorë (njohuri të përgjithshme). <p>Numërori</p> <ul style="list-style-type: none"> - Numërorin si fjalë që tregon sasi. <p>c) Drejtshkrim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i shenjave të pikësimit ., ?, !. - Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit. - Shkrimi i fjalëve mohuese <i>nuk</i> dhe <i>s'</i>. - Drejtshkrimi i foljeve të rregullta në kohën e tashme. - Drejtshkrimi i foljeve të rregullta në kohën e ardhme. - Drejtshkrimi i foljeve të rregullta në kohën e shkuar. 	<ul style="list-style-type: none"> abstraktët; - lakon emrat; - lakon mbiemrat; - lakon përemrat vetorë; - dallon përemrat vetorë që dalin me 2 trajta gjatë lakimit (të plotë e të shkurtër); - lakon përemrat pronorë; - dallon dhe përdor përemrin pyetës (<i>kush, cili, çfarë, ç, sa</i>); - gjen dhe përdor në fjali përemrin dëftor; - zgjedhon në kohën e tashme, në kohën e kryer të thjeshtë dhe në kohën e pakryer foljet <i>marr, dal, jap dhe shoh</i>; - dallon lidhëzat; - dallon parafjalët. <p>c) Fjalëformim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon fjalët e parme nga fjalët jo të parme; - dallon pjesët përbërëse të fjalës: rrënja, tema parashtesa, prapashtesa, mbaresa. <p>d) Drejtshkrim</p>
--	--

<ul style="list-style-type: none"> - Drejtshkrimi i mbiemrave. - Drejtshkrimi i përemrave vetorë. <p>d) Leksikologji dhe semantikë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sinonimet dhe antonimet. - Përdorimi i fjalorit për të gjetur kuptimin e fjalëve të panjohura. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor drejt shenjat e pikësimit: (.) (,) (') (:)? (!) (!?) (“,”) (-); - vendos saktë shenjat e pikësimit në dialog; - përdor saktë shenjat e pikësimit në ligjëratën e drejtë; - përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë, tek emrat e përveçëm dhe në rastet e tjera, si: emërtimet e rrugëve, institucioneve etj.;
<p>Njohuritë për klasën e katërt</p> <p>a) Sintaksë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dallimi mes një teksti dhe një grup fjalish që nuk kanë lidhje kuptimore. - Grupet kryesore në fjali, veprime me grupet e fjalëve. - Grupet plotësuese në fjali, veprime me grupet e fjalëve. - Kryefjala, njohuri të përgjithshme (me ndihmën e fjalëve pyetëse). - Kallëzuesi njohuri të përgjithshme (me ndihmën e fjalëve pyetëse). - Zgjerimi i grupit të kryefjalës dhe të kallëzuesit në fjali. <p>b) Morfologji</p> <p>Emri</p>	<ul style="list-style-type: none"> - shkruan saktë numrin shumës të emrave mashkullorë të tipit (shkëmb, mulli, lepur); - shkruan drejt mbiemrat e panyjshëm në numrin shumës; - përdor drejt apostrofin tek përemri pyetës ç’; - shkruan drejt datat. <p>e) Leksikologji dhe semantikë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton kuptimet e fjalës në kontekstin e dhënë; - dallon kuptime e figurshme të fjalëve; - dallon dhe përdor në fjali për të përmirësuar gjuhën e folur dhe të shkruar sinonimet, antonimet dhe homonimet; - përcakton se çfarë janë fjalët e urta dhe shprehjet frazeologjike dhe i përdor ato;

- Emrat e përgjithshëm e të përveçëm.
- Numri i emrit.
- Gjinia e emrit.
- Rasa dhe trajta e emrit.

Mbiemri

- Mbiemri, gjinia e mbiemrit.

Përemri

- Përemri pronor.
- Përdorimi në fjali i përemrit vetor dhe pronor.

Folja

- Zgjedhimi i foljeve kam dhe jam në kohën e tashme, të pakryer dhe të kryer të thjeshtë.
- Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e tashme
- Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e pakryer.
- Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e kryer të thjeshtë.

Ndajfolja

- Ndajfolja (njohuri të përgjithshme).

c) Drejtshkrim

- Shenjat e pikësimit në dialog.

- dallon fjalët dialektore nga fjalët e gjuhës standarde;
- përdor fjalorin për qëllime të ndryshme.

f) Fonetikë dhe fonologji

Nxënësi:

- gjen vendin e theksit në fjalë;
- dallon bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme.

- Përdorimi i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë, në emrat e njerëzve, emrat e përveçëm të kafshëve, emrat e vendeve.
- Shkrimi i fjalëve mohuese: askush, kurrkush, asnjë, asnjëri, asnjëra, askurrkush, kurrkund, kurrgjë etj.
- Përshtatja e mbiemrit të nyjshëm me emrin që plotëson.
- Drejtshkrimi i foljeve të rregullta në kohën e tashme, e kryer e thjeshtë, e pakryer.

d) Leksikologji dhe semantikë

- Kuptimi i fjalëve.
- Fjalët me shumë kuptime (njohuri të përgjithshme).
- Fjalët dialektore.

Njohuritë për klasën e pestë

a) Sintaksë

- Fjalja si njësi leksiko-gramatikore, logjike dhe me intonacion të përfunduar.
- Ndarja e fjalive sipas kumtimit.
- Grupi foljor dhe grupi emëror në fjali.
- Kryefjala e shprehur me emër, përemër, grup emëror.
- Kallëzuesi, me se shprehet.

- Përcaktori.

b) Morfologji

Emri

- Emrat konkretë dhe abstraktë.
- Kategoria e rasës, e shquarsisë dhe pashquarsisë të emrat.

Mbiemri

- Kategoria e rasës të mbiemrat.
- Përshtatja e mbiemrit me emrin.

Përemri

- Lakimi i përemrave vetorë,
- Përemrat vetorë që dalin me 2 trajta gjatë lakimit (të plotë e të shkurtër).
- Lakimi i përemrave pronorë.
- Përemri pyetës (*kush, cili, çfarë, ç, sa*).
- Përemri dëftor.

Folja

- Zgjedhimi i foljeve: *marr, dal, jap dhe shoh*, në kohën e tashme, në kohën e kryer të thjeshtë dhe në kohën e pakryer.

Lidhëzat

- Lidhëzat.

Parafjalët

- Parafjalët.

c) Fjalëformim

- Fjalët e parme dhe fjalët jo të parme.
- Pjesët përbërëse të fjalës: rrënja, tema parashtesa, prapashtesa, mbaresa.

d) Drejtshkrim

- Përdorimi i shenjave të pikësimit në fjalitë dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore.
- Shenjat e pikësimit në ligjëratën e drejtë.
- Përdorimi i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë, tek emrat e përveçëm dhe në rastet e tjera, si: emërtimet e rrugëve, institucioneve etj.
- Drejtshkrimi i shumësit të emrave mashkullorë të tipit (shkëmb, mulli, lepur).
- Drejtshkrimi i mbiemrave e panyjshëm në numrin shumës.
- Përdorimi i drejtë i apostrofit tek përemri pyetës ç’.

- Drejtshkrimi i datave.

e) Leksikologji dhe semantikë

- Kuptimet e fjalëve dhe kuptimet e figurshme.
- Sinonimet, antonimet dhe homonimet.
- Fjalët e urta dhe shprehjet frazeologjike.
- Dialektet dhe gjuha standarde.

f) Fonetikë dhe fonologji

- Theksi i fjalës.
- Bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme.

Vlerat dhe qëndrimet


Nxënësi:

- paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij;
- demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime;
- demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;
- vlerëson leksikun e gjuhës shqipe, dialektet, gjuhën standarde shqipe;
- respekton diversitetin gjuhësor mes njerëzve;
- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.

IV. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat e të nxënit janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një proces mësimor efektiv. Përdorimi i tyre do të shërbejë për zhvillimin gjuhësor dhe letrar të nxënësve. Mësuesit duhet të përditësojnë çdo ditë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësit dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë të suksesshëm dhe aktivë në jetën e përditshme. Metoda, strategji dhe teknika të tilla, si: *diskutim për njohuritë paraprake, kubimi, diagramë piramidale, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditaret e të nxënit, pyetja sjell pyetjen* etj. shërbejnë si nxitje për nxënësit në procesin e të nxënit dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e të nxënit. Gjithashtu, është e rëndësishme që **nxënësi të punojë me situata të nxëni** ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si “..pse...?”, “...a është gjithmonë e vërtetë...?”, “..çfarë ndodh kur...?” etj. Në këtë mënyrë ai inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e tij dhe të ndërmarrë situata të reja. Përmes situatave të të nxënit, nxënësi eksploron, zbaton dhe integron njohuritë dhe aftësitë gjuhësore, fiton aftësi intelektuale të nevojshme për të zhvilluar të menduarit krijues dhe kritik.

MODEL I NJË SITUATE KOMPLEKSE TË TË NXËNIT



- **Procesi mësimor duhet të karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:**

a) Mësimdhënie me në qendër nxënësin

Nxënësit do të jenë në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces do të ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësve. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi” kërkojnë që nxënësit të nxënë konceptet, të zhvillojnë shkathtësitë dhe të zbatojnë njohuritë gjuhësore. Këto diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të të nxënësve, të cilat përshtaten me objektin e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

b) Të mësuarit bashkëveprues

Mësuesit do të sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata do të përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarit bashkëveprues. Nxënësit gjatë orëve të gjuhës shqipe shpesh do të nxiten të punojnë së bashku. Detyrat e përbashkëta do t’u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur dhe për të ndarë përvojat e tyre me njëri-tjetrit. Njëherazi, edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe do të nxisë tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe do të ndikojë në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

- **Puna me nxënësit me nevoja të ve çanta, me vështirësi në të nxënë dhe me nxënësit e talentuar**

a) Nxënësit me nevoja të veçanta

Organizimi i kurrikulës sipas kompetencave (në fusha të nxëni, në shkallë) dhe me fokus integrimin i krijon mësuesit hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësit dhe për të personalizuar të nxënësve e tyre. Mësuesi duhet të marrë

parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motivim, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. Në disa raste duhen bërë përshtatje të kurrikulës sipas diferencave të zhvillimit brenda një grupi moshor. Mësuesi mund të zgjerojë zhvillimin e kompetencave kyçe sipas nevojave individuale të nxënësve, për të zvogëluar dhe zhdukur diferencat brenda një shkalle të kurrikulës, në fund të saj.

b) Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi në të nxënë arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënit njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

c) Nxënësit me vështirësi në gjuhën shqipe

Nxënësit që vijnë kryesisht nga emigracioni e zotërojnë gjuhën shqipe në nivele të ndryshme. Meqenëse programi është për të gjithë nxënësit, nxënësit me vështirësi në gjuhën shqipe duhet të arrijnë rezultatet e të nxënit si të gjithë nxënësit e tjerë. Këtyre nxënësve duhet t'u jepet mbështetje në formën e kohës shtesë, aq sa u duhet për të mësuar mirë gjuhën shqipe ose t'u ofrohen kurse formale nga shkolla, përgjatë vitit shkollor ose gjatë pushimeve verore.

d) Nxënësit e talentuar

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar. Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme elemente specifike të

kompetencave kyçe dhe specifike të fushës, të fokusohen në çështjet kroskurrikulare, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënësve brenda dhe jashtë shkollës.

- Udhëzime për leximin e teksteve letrare dhe joletrare

Gjatë mësimin të gjuhës shqipe nga klasa e parë deri në klasën e pestë nxënësit do të lexojnë tekste letrare dhe joletrare.

Përsa i përket përfaqësimit të teksteve letrare dhe teksteve joletrare, gjatë dy shkallëve të para këshillohet të respektohen afërsisht raportet: **60% me 40%**

Për leximet e teksteve letrare këshillohet të zgjidhen pjesë përfaqësuese nga letërsia shqipe dhe botërore në përshtatje me moshën dhe zhvillimin e fëmijëve. Këto tekste duhet të plotësojnë kriteret artistike dhe didaktike të gjetësisë, të strukturës dhe qartësisë së gjuhës.

Këshillohet që nxënësit të lexojnë fragmente dhe vepra nga periudha të ndryshme letrare, nga letërsia antike deri te ajo bashkëkohore, përfshirë këtu edhe krijimtarinë gojore folklorike.

Leximet jashtë klase

Këshillohet që **përgjatë një viti shkollor të zhvillohen 3-4 vepra ose pjesë për lexime jashtë klase**. Orët e leximeve jashtë klase, mësuesit duhet t'i vendosin në planin e tyre mësimor, kur të bëjnë zbërthimin analitik të programit. Është e rëndësishme që gjatë këtyre orëve, nxënësve t'u krijohet mundësia të zgjedhin edhe vepra që janë të pëlqyera e të preferuara për ta.

Veprat e rekomanduara për lexime jashtë klase duhet të jenë:

- nga letërsia shqipe dhe letërsia botërore;
- nga autorë të periudhave të ndryshme;
- nga gjini dhe lloje të ndryshme letrare.

Përzgjedhja e leximeve jashtë klase nga autorë të ndryshëm, periudha të ndryshme, nga gjini dhe lloje të ndryshme letrare krijon mundësi për pasurimin e përvojës letrare së nxënësve.

V. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënësit. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në procesin e të nxënësit dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien. Vlerësimi i nxënësve për fushën “Gjuhët dhe komunikimi” ka për synim matjen e kompetencave të fushës të paraqitura nëpërmjet rezultateve të të nxënësit.

Llojet e vlerësimit

Vlerësimi diagnostikues zakonisht kryhet në fillim të shkollës, vitit shkollor ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth asaj, për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies të mësuesit dhe të nxënësit e nxënësve në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

Vlerësimi i vazhdueshëm është një proces, që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të nxënësit. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësit.

Vlerësimi përmbledhës kryhet më shpesh në fund të një grupi orësh, për të përcaktuar çfarë është mësuar mbas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përmbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e nxënësve, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxënësit.

Gjatë zbatimit të programit nxënësve duhet t’u jepet mundësia të punojnë edhe në grup, për kryerjen e detyrave të cilat mund të zgjidhen me këtë metodë pune. Në këto raste mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi dhe të secilit nxënësi, në veçanti.

Komponentët e vlerësimit janë vlerësim me gojë dhe vlerësim me shkrim. Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim. Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë për prezantimet me gojë, në testimet periodike me shkrim dhe në punët me shkrim, të zhvilluara individualisht ose në grup.

Një formë e vlerësimit me shkrim nga nxënësit janë edhe testimet.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm për të matur kompetencat gjuhësore të nxënësve. Njohja e këtij niveli, tashmë, nuk mund të bëhet vetëm me rrugët praktike e tradicionalisht të njohura, si: qortimet nga mësuesi. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Mësuesi duhet ta ndjekë gjithë procesin e të shkruarit që nga planifikimi dhe deri tek rishikimi dhe redaktimi. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve; ato duhet të jenë të tilla që t'i motivojnë ata. Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

Përveç punëve dhe testeve me shkrim, mësuesit mund të kryejnë vlerësime të bazuara në performancën e nxënësve, duke përdorur mënyrat e mëposhtme, si: projektet kurrikulare dhe ndërlëndore; lojërat me role, detyrat individuale, bisedat letrare, debatet, vrojtimit, portofoli i nxënësit etj.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë punë me shkrim, detyra tematike, projekte lëndore e ndërlëndore etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësi, mësuesi rekomandon. Pjesë e vlerësimit është edhe informimi i nxënësve dhe prindërve për rezultatet e vlerësimit.

VI. MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE

Për arritjen e kompetencave në fushën “Gjuhët dhe komunikimi” është e rëndësishme përdorimi i mjeteve dhe materialeve të shumta mësimore. Tekstet mësimore nuk duhet të jenë burimi i vetëm për marrjen e informacionit. Në procesin e të nxënësve duhet

përdorur materiale nga interneti, libra nga biblioteka e shkollës, fletë pune, udhëzues të ndryshëm etj.

Këto matariale duhet të jenë të qarta, të sakta, me një gjuhë të kuptueshme, në përputhje me programin dhe nuk duhet të përbëjnë ngarkesë për nxënësit.

ⁱUdhëzime më të detajuara, sidomos për shkallën e parë (klasa përgatitore, klasa 1 dhe 2) do të jepen në udhëzuesit kurrkikularë. Këta udhëzues do të jenë në ndihmë të mësuesve dhe punës së tyre të përditshme.